



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:048041

Datë: 27.01.2025

Numri i dokumentit: 06762756

P.nr.183/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Gjyqtarja e vetme gjyquese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.B, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Tregtia e ndaluar*” nga neni 299 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP/II.nr.2178/2023 të datës 29.02.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik të datës 24.12.2024, të mbajtur në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, i pandehuri M.B, mbrojtësi i të pandehurit av.Dritëro Kollçaku, nga Peja, sipas autorizimit, me datën 27.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 27.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M.B, i lindur me datë, në Pejë, nga babai Sh. dhe nëna S., e vajzërisë, me vendbanim në rr. “.....”, nr., në Pejë, me profesion, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr..... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, posedon nr. të telefonit, Shqiptar, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 02.11.2023, në Pejë, në Subjektin Ekonomik-Barnatoren “.....” me dashje pa autorizim shet barëra, në atë mënyrë që pas një kontrolli të Policisë dhe Inspektoratit Farmaceutik të Ministrisë së Shëndetësisë, në barnatoren e sipërshënuar dhe veturën “.....” ngjyrë e, me targa pronë e të pandehurit, kanë gjetur një sasi të konsiderueshme të barërave pa banderola të MSH-së, dhe pa u bërë kontrolli i nevojshëm nga personi i autorizuar, të përshkruara si në procesverbalet me nr, dhe të cilat më pas janë sekuestruar.

- Me çka ka kryer veprën penale “*Tregtia e ndaluar*” nga neni 299 par.1 të KPRK-së.
Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 79 par.4 të KPRK-së dhe 299 par.1 dhe 299 par.4 të KPRK-së, dhe neneve 242, 277, 364, 449, 450, 452 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. Me **DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej tremijë (3000) euro, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim policor prej dyzetetë (48) orësh, duke filluar nga dt. 02.11.2023 deri me 04.11.2023, ku një ditë e ndalimit i llogaritet në shumën prej njëzetë (20) euro, gjithsejtë në shumën prej dyzetë (40) euro, me çrast i njëjti obligohet që të paguajë shumën prej dymijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë (2960) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguaj brenda afatit prej tre (3) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.
- II. Si dhe me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej tetë (8) muajsh, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.
- III. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën të cekur si më lartë brenda afatit të lartcekur, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, gjykata do të e zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku njëzetë (20) euro, gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.
- IV. Nëse i pandehuri gjatë periudhës së verifikimit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kryen vepër tjetër penale, dënimi i kushtëzuar në kohëzgjatje prej tetë (8) muajsh, do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- V. **OBLIGOHET**, i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzetë (20) euro, e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- VI. Konform nenit 299 par.4, të KPRK-së, **KONFISKOHEN** – medikamentet e përshkruara sikurse në procesverbalin nr..... me nr. rendor nga, procesverbali me nr..... me nr.rendor, procesverbali me nr..... nga nr....., të cilat janë sekuestruar me datën 03.11.2023, dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, urdhërohen që të shkatërrohen sipas standardeve të përcaktuara ligjore.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me datë 29.02.2024 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2178/2024, ndaj të pandehurit M.B nga Peja, për shkak të veprës penale “Tregtia e ndaluar” nga neni 299 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën fillestare me datë 24.12.2024, e cila u mbajt në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit M.B, si dhe mbrojtësit të të pandehurit av.Dritëro Kollçaku nga Peja, sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës PP/II.nr.2178/2023 të datës 29.02.2024, nga ana e Prokurorit të Shtetit, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe tutje ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe pasi

që i pandehuri M.B, ka deklaruar që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë me ç'rast i njëjti me vullnet e vetëdije të plotë ka deklaruar se *e pranon fajësinë* për veprën penale e cilat i vihet në barrë, se ndihet i penduar dhe premtun se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tjera penale.

Andaj, gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç'rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*. Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit M.B, av. Dritëro Kollçaku ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim*.

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, e që pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: Raporti i policit A.B i datës 03.11.2023; Deklarata e të pandehurit M.B e dhënë me dt. 02.11.2023 në St Policor në Pejë dhe në PTH në Pejë me dt.23.02.2024; Procesverbalet mbi inspektimin e kryer me nr.,,, të datës 02.11.2023; Çertifikata e regjistrimit me nr. 810771932; Aktvendimi i Drejtorisë së Inspektionit me nr. 13-334-41729/4912 i dt. 07.04.2016; Licenca e veprimtarisë me nr. të Licencës L5-0748/28/09/2018; Licenca e punës me nr. RKS-0606-18; Raport i inspektionit nga Inspektorati Farmaceutik me nr. ref. 10/J-064/PF-23, 10/J-063-23 të dt. 06.11.2023; Foto-dokumentacioni i shkresave të lëndës. Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që në kuptim të rrethanave rënduese të marr parasysht ndonje dënim eventual të mëparshëm ndaj të pandehurit ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë*.

Mbrojtësi i të pandehurit M.B, av. Dritëro Kollçaku ka deklaruar se: *i propozojmë gjykatës që pranimi i fajësisë të merret si rrethane posaçërisht lehtësues, gjithashtu moshë e tij e re, është person familjar, është hera e parë që bie ndesh me ligjin*.

I pandehuri M.B, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale të cilën e kam kryer, i premttoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale, kjo është hera e parë që gjendem në gjykatë*.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit,

qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Tregtia e ndaluar*” nga neni 299 par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, faktin se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, ndërkaq rrethana rënduese përveç elementeve të veprës penale për të pandehurin gjykata nuk gjeti.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me kusht u mor në përputhje me nenin 48 par.1 dhe 2, e lidhur me nenin 49 par.1, dhe par.4 të KPRK-së, e po ashtu me 299 par.1 të KPRK-së, sipas të cilit është parashikuar se formën themelore të veprës penale e kryen: “*Kushdo që pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallrave sendeve apo shërbimeve, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në katër (4) vjet*”, ndërkaq ku në dispozitivin par.1 të nenit 49, që i referohet kushteve mbi shqiptimit e dënimit me kusht përcaktohet se: “*Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet*”, ndërkaq në par.4 përcaktohet se: “*Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale*”. Ndërkaq sipas par.5 të nenit 49 të KPRK-së, i cili përcakton se: “*Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim*”, gjykata ka shqiptuar dënim me kusht vetëm sa i përket dënimit me burgim. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej 1 viti do të kryej veprë tjetër penale ndaj tij do të ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që i njëjtit të parandalohet në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse i pandehuri dështon, refuzon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë është marrë konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për llogaritjen e ndalimit të të pandehurve për dyzetetë (48) orë në dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 79 par.4 të KPRK-së, i cili shprehimisht parasheh se: *“Një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim dhe njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni”*.

Vendimi për revokimin e dënimit me kusht nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale, është marrë konform nenit 50 par.2 të KPRK-së, andaj ka vendosur si në pikën e IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi si në pikën e V të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimet, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimet, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke u bazuar në dispozitat e nenit 299 par. 4 të KPPRK-së, me ç’rast, medikamentet e përshkruara sikurse në procesverbalin nr..... me nr. rendor nga.....procesverbali me nr.,,,, me nr.rendor procesverbali me nr.... nga nr...., të cilat sipas urdhrit ndalues përfundimtar UGJK.nr....., të, janë konfiskuar dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, do të bëhet shkatërrimi i tyre.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.183/24, me datë 27.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjyquese

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.